



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 28/2010

Prishtinë, 13 07. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Mursel Haljilji, Adem Grabovci, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Mufëra Şinik, Qamile Morina, Zef Morina dhe deputetët Emrush Xhemajli, Driton Tali dhe Naim Rustemi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Shala, Liridon Mavriqi – MEF; Adriatik Berisha, Arsim Bruçaj – Telco AG; Lane D.Bahi dhe Bajram Gecaj- USAID, Besim Zeqiri –ICO; Besnik Ramadanaj – KDI; Jetmir Bakija NDI; Milazim Allshiqi, Avni Çallaku dhe Ramadan Makolli – SP-PTK dhe Ibrahim Krasniqi konsulent.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 07. 07.2010;
3. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës;
4. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 07. 07. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 07.07. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës;

Kryetarja – tha se Komisioni ka ftuar përsëri ministrin e Ekonomisë dhe Financave z.Ahmet Shala, për të paraqitur sqarime në lidhje me Propozim – Strategjinë e Privatizimit të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, të cilit ia kaloj fjalën.

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe Financave – theksoj se para Komisionit mund ti elaborojmë të gjitha çështjet e ngritura ne mbledhjen e kaluar, për participimin e Strategjisë të sektorit privat në PTK. Duke vazhduar se ne dëgjimin e parë janë ngritur disa çështje, andej MEF-i si bartës ne këtë proces me këshilltaret e transaksionit ka përgatitur një ankese Raport me pyetje përgjigje të parashtruara nga mbledhja e kaluar. Ne strategjinë e propozuar janë marr parasysh të gjitha dilemat e punëtorëve të PTK-së dhe po shqyrtohen të gjitha propozimet dhe elemente ngritura nga deputet. Sa i përket infrastrukturës ligjore, komerciale janë dhënë përgjigjet nga ana e profesionistëve me shkrim. Po ashtu ne këtë strategji do të jenë të përfshirë të gjithë akterët dhe faktor që janë për zhvillimin e këtij sektori, dhe gjatë procedurës së përgatitjes së dosjes së tenderit do të merren parasysh dhe janë në shqyrtim sugjerimet dhe vërejtjet e deputetëve. Në fund kërkoj nga Komisioni funksional të miratohet në mënyrë që të procedohet sa më parë në seance plenare në këtë sesion pranveror.

Adem Salihaj – pyeti se operatori virtual Z-mobile a është në kuadër të telefonisë mobile Vala apo është telefoni mobile e re dhe kërkoje sqarime? Dhe po ashtu pyeti për vlerën asteve të PTK-së, se sa është kjo vlerë?

Adem Grabovci -Theksoj që ne kemi kërkuar nga Qeveria Kosovës se ku duhet të investohen mjetet e privatizimit të PTK-së, dhe ne kemi marr përgjigje shumë të qarta, se një pjesë e këtyre mjeteve do të investohen në infrastrukturën rrugore. Ndërsa sa i përket asaj se duhet të privatizohet PTK-ja, tha që ne jemi përcaktuar për privatizim sepse tani ne e kemi pranuar sistemin për ekonomi të tregut të lirë.

Kaqusha Jashari - Kërkoje që në këtë strategji duhet me dhënë dhe disa përgjigje, lidhur me planifikimin e saktë se si do të shpenzohen këto mjete. Po ashtu tha se pari duhet të ketë një plan të detajuar për mënyrën e shpenzimeve. Pyeti se a do të privatizohet në pako edhe operatori virtual Z-mobile?

Fatmir Rexhepi - tha që si Parlament së bashku me Qeverinë duhet ta kemi një objektiv se ku do te arrijmë me privatizimin e PTK-së dhe theksoj së duhet te mendojmë mire që ti gjejmë alternativat ne këtë strategji që ky procese të shkoje sa më mirë. Metoda e privatizimit më qene së është e hapur, atëherë duhet te mendohet së çka do të behet me punëtorët në të ardhmen, me politikat e investimeve etj. Ka shumë fusha dhe sektor që do të duhet të zhvillohen me këto mjete te privatizimit. Ne si Komision duhet ti dërgojmë ne Kuvend Rekomandimet për ne seancë plenare, t'i diskutojmë së cila është metoda më e mire për privatizim në të mirë të vendit. Kështu që si Komision dhe Kuvend duhet t'i përafrojmë mendimet lidhur me strategjinë për privatizimin e PTK-së.

Múfera Şinik – theksoj së te gjitha përgjigjet e dhëna nga ana MEF-it janë që te këtë një privatizim të suksesshëm dhe që te gjendet metoda ma e përshtatshme. Tha qe ne si Komision dhe Kuvendi, duhet ta aprovojmë Strategjinë për privatizimin PTK-së, që Qeveria se bashku me grupin ndërministrorë ta përgatisë pakon tenderuese për privatizim të PTK-së.

Ethem Çeku- tha që nuk kemi përgatitje të infrastrukturës të nevojshme ligjore për privatizimin PTK-së, dhe duke marr parasysh këtë fakt nuk besoj që do te këtë suksese strategjia për pakon tenderuese. Theksoj se Komisioni është duke e monitoruar Ligjin për Telekomunikacion, dhe gjatë takimeve për monitorim ligjit ne fjalë me përfaqësuesit: MTPT-së; ART-së dhe PTK-së, jemi njoftuar dhe informuar për detajet që ka zbrazëtira ligjore ne funksionimin rregullt te operatoreve Vala dhe Ipko. Prandaj këto janë shqetësimet qe mos te ngutemi ne vendimet e shpejta, për strategjinë e privatizimit te PTK-së pa u realizuar infrastruktura ligjore, sepse me këtë metode dhe forme mund te mos kemi investitor serioz. Pastaj duke eliminuar paqartësitë, dilemat dhe duke debatuar mund të përgatisim dhe ta hartojmë mire pakon tenderuese për privatizim PTK-së.

Qamile Morina – konstatoi se në parim të gjithë jemi për privatizim. Por jemi te shqetësuar për kohen dhe mënyrën e hartuar te strategjisë, metodën dhe bazën ligjore te privatizimit. Dhe kërkoj që te kemi llogaridhënie para dhe gjatë procesit te privatizimit të PTK-së. Pyeti për grupin ndërministror që është themeluar ne 2008, ku ka pasur për qëllim të studioje metodat më të mira të privatizimit dhe a është grupi ndërministrorë ai që do ta përgatisë pakon tenderuese të privatizimit të PTK-së? A keni pasur raporte nga komisioni i cili është themeluar për monitorimin e ndërmarrjeve publike? Pse PTK-ja nuk mundet të operoj me sukses? A do te shkoj një here posta në shitje, pastaj te behet kthimi i Postes me obligim, apo pa obligim?

Murselj Halilji - tha se në qoftë se shikojmë procesin e privatizimit që po ndodhe, a po behet ne bazë te ligjit, dhe nëse po në bazë te cilit ligji po privatizohet PTK-ja? Theksoje që dhe me privatizimin PTK-së, është dashur të merret AKP-ja, e jo komisioni ndërministrorë që ta hartojte strategjinë. Pozicioni dhe shtija e vlerës do te ishte më e mire për PTK-në. Sepse ka te paktën procedura dhe bazë ligjore më të mirë. Do të ishte mire më shikuar se si kanë ecur proceset e privatizimit në regjion, që dinamika dhe angazhimi i jone të jetë i suksesshëm lidhur me privatizimin e PTK-së.

Sala Berisha Shala – tha se në fakt si deputet e kemi rrolin e ligjvënësit dhe të gjitha akuzat se ne po bëjmë privatizim në mungesë të Ligjit kjo na prek të gjithëve edhe si deputet edhe si Qeveri sepse ne dimë rregulloren e Punës së Kuvendit, nuk mund ta akuzojmë njëri tjetrin në këtë rast për neglizhencë të paqartësive në këtë. Tha se jemi me vonesë për nxitjen e një debat të tillë dhe nuk dihet se a jemi korrekt me kronologjinë e ngjarjeve, sepse sot e kemi vazhdimin e këtij debati për strategjinë e privatizimit të Postës, ndërsa nesër e kemi një Dëgjim Publik që ka të bëjë me monitorimin e Ligjit për Telekomunikacionin, dhe sigurisht se Dëgjimi Publik do ta prek edhe privatizimin e Postës, dhe tash lind pyetja se a është dashur ta kemi së pari atë dëgjim publik e pastaj të kompletohemi dhe ta vazhdojmë debatin me strategjinë e privatizimit të Postës? Në fund tha se është pro privatizimit edhe duhet të kërkojmë gjithherë si deputet por edhe si Qeveri, të kemi një bashkëpunim të ngushtë në këtë drejtim, të jemi përfitues të gjithë pavarësisht ngjyimeve politike.

Zef Morina – tha se nga takimi i kaluar është vërejtur se asnjëri nga ne nuk është kundër privatizimit, kjo është e qartë. Por ajo që shumë koleg i ka shtyrë me dyshuar është forma apo arsyeshmëria se si të rrumbullakohet ky proces. Mirëpo të pa qarta janë p.sh përgjigja tek ndikimi i konkurrencës nga ana e IPKO-së dhe e dy operatorëve D3- mobile edhe Z-mobile. Është e vërtet që konkurrenca nuk do ta ulë profitin por do ta shtojë kualitetin tek operatorët, tek kompanitë, të cilat dëshirojnë me punuar. Sa i përket Z-mobile edhe D3-shit, ne vërtet i kemi pasur disa kërkesa edhe disa takime edhe me PTK-në, edhe me Ministrinë, edhe me ART-në, dhe të gjithë kanë thënë se kjo është në interes të PTK-së, në interes të VALE-ës, në interes të Telekomit të Kosovës, për me shtri aktivitetin më tepër në teren. Dhe në këtë mënyrë tash po del e kundërta. Në pyetjen të cilin ja ka bërë Ministrit dhe nuk më është përgjigj, përveç asaj anën pozitive edhe negative të privatizimit sa ka qenë edhe a u bo ndonjë vlerësim i sakët i PTK-së, tani sa është vlera? Pyeti se a do të ishte më mirë që përgatitjet gjithsesi të bëhen por të punohet pak më shumë, edhe të pritet edhe pak që të fitohet kodi shtetëror i telefonisë? Sepse në mungesë të kodit është shumë e vërtet që vlera do ti ulët shitjes së kompanisë, dhe nuk është faji as te Qeveria, as te ART-ja. Tha se personalisht nuk pajtohet që të jetë 25% aksioni i Qeverisë, thjeshtë si qytetarë sepse ka mundësi siç janë shitur edhe në vendet e rajonit të jetë përqindja më e lartë. Kjo i ka dy anët pozitive, nën një që sigurisht që do ta ruajmë një vlerë shumë më të madhe, dhe fjala jonë do të ketë ndikim që kompania të jetë më e madhe, edhe nën 2 nëse ne nesër do ta blejmë e dimë se sa do të kemi mundësi edhe do ta kthejmë prapë në pronë tonën, kjo kishte më qenë shumë me rëndësi që mundësisht të insistohet të bëhet edhe një vlerësim, të bëhet edhe një llogari që përqindja të mos jetë kaq, por të rritet. Në fund tha se e përkrah privatizimin, natyrisht me disa gjera të cilat duhen të sqarohen pak më tutje edhe këto vërejtje e cekura më lartë të merren më seriozitet.

Naim Rrustemi – tha se PTK-ja përballet me një varg parregullsish të supozuara të kontrolluara publikisht të paraqitura në organet e drejtësisë, siç është Prokuroria edhe EULEX-i me fjalë të tjera kemi të bëjmë me kontrata të këqija edhe është mirë me u sqaruar para se me marrë vendim për privatizim si rasti i Daradafon edhe Dardafon .net. Gjithashtu kishte me qenë mirë me trajtuar edhe çështjen e telefonisë së katërt mobile në Shqipëri pas shumë fjalëve tjera e ne as një hap nuk e kemi parë edhe aty PTK-ja ka

investua 2.4 milion euro, por rasti i fundit është pas vendimit të Qeverisë që të ndërprej investimet kapitale për platformën e faturimit të paraqitet rasti kur njëra nga kompaniët padit PTK-në dhe ndoshta po flasim për një dëmshpërblim pa paragjykim por është çmim milionëshe, milionëshe. Në strategjinë e ofruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk është paraqitur mirë edhe qart se si do të shthurën nga aspekti ligjor edhe financiar dhe si do të bëhen shthurjet e llogarive i njësive brenda PTK-së, cila është VALA, cila është Telekom i cila është Posta sepse Qeveria e ka pruar një model shumë të zyrtë shumë të çuditshëm që lenë hapsirë që ta keqpërdorjë sepse vetëm me një kator e ka cek se vetëm pas privatizimit do të disktojmë për kthimin e Postës. Arsyeja që ka ofruar Qeveria ka qenë se PTK-ja, po menaxhon keq edhe duhet ta privatizojmë, pse nuk e ka fut të njëjtën strategji kur e ka futur koncesionimin e Aeroporitit.

Driton Tali – shtrohet pyetja e atij çekut rreth 16.200 milion euro se si ka ndodhur puna e dhënies së licencimit të IPKO-së, tash edhe për Z-mobilin për kënd po flasim a po flasim për Dardafonin apo për Dardafon .net -in sepse na kanë përzi krejt asgjë nuk po marrim vesh nëse e ka dëmtuar PTK-në. Dhe nëse ju kujtohet kur na e sjellet një strategji ku thuhet se mund të paguhet 500 milion euro, dhe pata pyetur se kush e ka vlerësuar Postën, z.Shala ka thënë se e kemi vlerësuar në mënyrë konservative. Dhe mund të them se ne po privatizojmë diçka, qe as vetë nuk po e dimë se çka po privatizojmë dhe përsëri do të shkojnë me atë metodën me ankand të mbyllur do të ipen disa oferta të fshehta. Vijmë edhe te siguria e shtetit, çka do të humb Kosova në telefoninë në aspektin e sigurisë së shtetit edhe nëse shteti i mban 25% aty kemi të bëjmë me një resurs ku ekspertet e shtetit duhen të involvohen sepse atëherë të gjithë do të përgjohemi dhe nuk e dimë se nga po përgjohemi, edhe për çfarë arsye apo duhet të jetë licencë e dhënë në dorë që është shumë me rëndësi për shtetin e Kosovës.

Kryetarja – theksoj se duke e marrë parasysh se ministri sa herë që e ftojme vije në Komision, kjo qet në pah se ka vendosur çështjen e transparencës dhe llogaridhënies para Kuvendit, që është detyrë edhe në bazë të rregullores së Kuvendit. Mirëpo çështja që kërkon në strategji në kohën kur e ka parë të arsyeshme Ministria të përfundojë koha e inicimit të privatizimit, por do të dalim nga vija partiake dhe të flasim në emër të qytetarit, të bisedojmë për të mirën e zhvillimit ekonomik të Kosovës, si do të mund të arrihet kjo kur dihet se e gjithë strategjia ka arrit në korrik të vitit 2010 në Kuvend të Kosovës. Nuk jam kundër ekonomisë të lirë të tregut, është një Kushtetutë të cilën e kemi miratuar ne vetë si deputet të Kuvendit të Kosovës, në të cilën e kemi ofruar Kosovën për një ekonomi të lirë të tregut, Neni 119 i saj, ku thot që Kosova është shtet i lirë demokratik për një ekonomi të lirë të tregut, por më interes është se çka po përfiton Kosova prej privatizimit të PTK-së. Është pa që korrupsioni në ndërmarrjet publike është nën normale, është pa që menaxhmenti në ndërmarrje publike ka dështuar. U përfol nga të gjithë deputetët se asnjëri nuk është për mos privatizim por neve na intereson se çka po përfitojmë dhe çka po humbim cilat janë alternativat edhe me cilën metod do të privatizohet? Nuk e di se çka do të përfitojmë duke e marrë parasysh që PTK-ja edhe ashtu keq e menaxhime i ka dhënë dividenda gjithherë shtetit për mbulimin e një pjese të madhe të buxhetit, ju e dini vjet i keni marrë dikun rreth 200 milion sivjet. Pyeti se cila kishte me qenë metoda që mos të shkojmë me 75% të

aksioneve të shitjes? Duhet ë vendosim në të mirë të qytetarëve sepse ne një ditë do ta lëmë dhe do të vijnë të tjerët ta udhëheqin çështjen e Kosovës dhe në fund se çka do të përfitojmë dhe çka do të humbim sipas këtij procesi.

Adem Salihaj – kërkoj sqarim që telefonia 045 e cila është krijuar plotësisht nga Vala dhe për interesa të Valës për përdorim të saj, tash është kompani krejtësisht tjetër a është kjo përgjigja juaj apo është telefoni që nuk ka më lidhje me Valën?

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe Financave – u përgjigj në pyetjet e deputetëve: ndërmarrjet publike sikurse edhe çdo institucion tjetër publik kanë auditimin vjetor edhe të pasqyrave financiare, edhe të çdo veprimi tjetër. Mirëpo do të ju thirrja juve që nëse keni ndonjë çështje kaq serioze për ndonjë të bërë apo të pa bërë në bazë ligjore, Auditori gjeneral është institucion i cili auditon dhe i raporton, të cilat raporte edhe do të botohen. Ju kisha lut nëse keni ndonjë dyshim tjetër të shkeljeve ligjore ju si person si individ mund ti ngritin çështjet në institucionet përkatëse. Në bazë të informacioneve si MEF çështja e licencimit të operatorëve virtual është bërë në bazë të kompetencave të ART-së, çështja e kontratës së PTK-së me operatorët virtual është lidh në bazë të kompetencave që ka bordi i PTK-së. Mendoj se Greqinë nuk duhet marr si shembull sot për të krahasuar dhe po shihen pasojat e vendimeve jo te kthjelltë që kanë marrë.

Fatmir Rexhepi – për dy vjet nuk duhet me u ndërtuar autostrada se s’kemi fuqi dhe s’kemi potencial. Të gjitha zhvillimet e tjera kanë me mbet mangët edhe kanë me shkuar në drejtimin e kundërt, ky është koncepti.

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe Financave – Sipas të gjitha analizave që kanë bërë ekonomistë vendor dhe ndërkombëtar investimi i cili do të ndërrojë edhe pozitën gjeoekonomike, gjeostrategjike edhe të fluksit të trendëve të tregtisë edhe të komunikimit në regjion janë investimet në autostradën, e cila e hapë derën e komunikimit të Kosovës edhe me Detin Adriatik, edhe me shtetin amë Shqipërinë. Uroj që kjo rrugë të vazhdojë edhe në lindje dhe Kosova të bëhet një urë lidhëse e gjithë regjionit. Në aspektin e kalkulimeve të ndikimit në GDP sipas vlerësimeve më konservative të mundshme është prej 1.5 deri 2.5% rritje të GDP-së prej ndikimit të drejtpërdrejtë të Autostradës Morinë-Merdare. Tani është përfunduar raporti për ndërmarrjet publike dhe së shpejti do të vjen në Kuvend dhe jemi të obliguar të raportojmë një herë në vit dhe ky raport është mjaft kritik dhe real, dhe gjendja nëpër ndërmarrjet publike nuk është e lakmueshme. Konsideroj se metodologjia më e mirë për të ngritur efikasitetin e menaxhimit në ndërmarrjet publike në specifikat qofshin sociologjike qofshin kulturore që i ka Kosova është futja e sektorit privat në Kosovë.

Qamile Morina – në qoftë se Qeveria do ta zbatonte ligjin për ndërmarrjet publike, ligji në fjalë e bënë Qeverinë si aksionare e cila duhet të mbikëqyrë shumë ndërmarrjet edhe në mënyrë rigorozë. Dhe çdo mos arritje e qëllimeve synimeve vjetore ajo urgjent duhet të merr masa që ti korrigjojë këto dështime, bile i lejohet për një vit, dy vite të ndërrojë krejt bordin edhe ta njoftojë Kuvendin për këto çështje, d.m.th nëse këto ndërmarrje nuk kanë punuar mirë dy vite atëherë mund të i atribuohet Qeverisë e cila nuk ka zbatuar ligjin dhe nuk ka vepruar me kohë. Moszbatimi i ligjit po na bien këtu ku jemi.

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe Financave – Grupi ndërmintor ka obligim të ndërmerr masa pas raportit të publikuar dhe vlerësimit të performancës për masa konkrete ndaj atyre anëtarëve të bordit ose menaxhmentit të ndërmarrjeve publike që nuk kanë performuar konform objektivave që kanë aprovuar. Dhe ne do ti bëjmë ato dhe ju do të jeni dëshmitarë, dhe ende dy vjet s'kanë kaluar se anëtarët e bordit emërohen pas emërimit nga Qeveria dhe nënshkrimit të përfaqësuesit civil ndërkombëtar.

Kaqusha Jashari - tha mendoj se duhet me bërë një specifikim të projekteve prioritare. Për autostradën ne duhen kaq për projektet tjera. Prandaj unë nuk jam për me shitë 75 e 80% e mi fut paret e privatizimit në buxhet sepse shumë shpejt kanë me u avulluar. Se na vyejnë shumë çka të varfër jemi, prandaj këto mjete duhet me shkuar vetëm për projekte të cilat e kanë kthimin, zhvillimin ekonomik edhe ndonjë projekt social. Prandaj nuk do të votoj në këtë mënyrë me shitë 75% e të shohim çka po bëhet nuk bënë kështu, por sipas nevojave të bëhet edhe shitja e PTK në përqindje të caktuara. Pra këtë e kam kërkuar të dihet cila është vlera e PTK-së.

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe Financave – nuk është veprim i shpejtë që po e bëjmë, u tha që në vitin 2008 Qeveria ka aprovuar në parim që të studiohet futja e sektorit privat në ndërmarrjet publike në përgjithësi duke përfshirë edhe PTK-në, dhe pothuajse ka një vit që janë studiuar të gjitha aspektet dhe kanë ardh deri te një konkludim. Sa i përket nevojave të investimeve në Kosovë janë identifikuar të paktën 7 miliard euro projekte që ka nevojë të financohen, kah të vijnë ato para nga sektori privat nga borxhet nga rritja e taksave apo nga kush? Ne konsiderojmë që këto projekte duhet të financohen kryesisht nga sektori privat dhe kjo është kjo është zgjidhja më e mirë që është konsideruar deri më tani. Konsideroj që futja e parave të PTK-së dhe të ndërmarrjeve publike në karakter të infrastrukturës rrugore rrit shpejtësinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, dhe integrimin e saj në gjithë regjionin, dhe përveç kësaj kemi futë edhe projekte tjera sociale. Vetëm këtë vit kemi aprovuar 3 ligje kostoja e të cilave e kalon 30 milionshin në aspektin social, kryesisht qoftë invalidët e luftës, qoftë veteranët e UÇK-së, qoftë pagat e shërbyesve civil, andaj kemi bërë një balancë të kujdesshëm një kombinim i cili siguron edhe ngritjen e nivelit zhvillimor edhe nivelit social.

Qamile Morina – Njësia për politika dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike me rishikimin e buxhetit i është rritë vlera për mbi 6 milion për këtë njësi. Edhe sipas nenit 28 Njësia për politika dhe mbikëqyrje të ndërmarrjeve publike, mbi baza ligjore mund të angazhojë edhe këshilltarë profesional dhe kompani vlerësimi dhe publikojë vlerësimin në faqen e internetit. Sinqerisht ju do të duhej ti kishit gjithë parametrat qysh në vitin 2009 që diçka nuk është duke shkuar në rregull me ndërmarrjet publike. Dhe ju keni pas mundësi se ligji ju ka garantuar që ju të veproni me kohë që mos të jenë këto kushte tash të disfavorshme në procesin e privatizimit. Andaj ligji nuk është zbatuar në ndërmarrjet publike në tërësi, dhe kërkoj që në faqet e internetit do të duhej të ishin raportet. Edhe pyetja tjetër ka qenë se a ka pas plan biznesi për vitin kalendarik 2010? A keni planifikuar në 2009 si do të shkojë procesi i privatizimit?

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe Financave – Së pari 14 milion euro për Njësinë për politika dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike janë për subvencione të ndërmarrjeve publike. Sepse aty kemi një staf prej 4 deri 5 vetave të cilët vërtetë janë duke e kryer punën me shumë përgjegjësi. Raportet besoj do ti keni brenda një jave ose maksimumi dy javë do ti keni në internet të publikuara sikurse edhe raporti i auditimit,. Apsolutisht jemi konform ligjit sa i përket edhe monitorimit edhe publikimeve, komisionet e bordeve janë aprovuar në fund të vitit 2008 edhe atëherë kur na ka mundësuar ligji. Raportet bëhen për vitin 2009 dhe nuk mund të bëhen para 6 mujorit të parë për shkak të efikasitetit dhe vëllimit të raporteve. Plani i biznesit ekziston me planet e ndërmarrjeve publike, ekzistojnë planet operative të ndërmarrjeve publike, plani i Qeverisë është plan i aksionarit dhe këtu duhet ti bëni dallimet sa i përket kësaj.

Adem Salihaj – tha se së pari Qeveria nuk duhet të hyjë në proces të privatizimit. Në parim jemi për procesin, por një vlerë siç është PTK-ja nuk duhet te vihet në shitje para se ta dimë një vlerë reale të saj. Së paku ta kemi në një vlerësim e pastaj varet shumë prej rrethanave të tregut, mund të ndodhë që në një moment tregu nuk është i favorshëm për shitjen e PTK-së ose është shumë i favorshëm dhe shitet më tepër se vlera reale, por mendoj që Qeveria ende se ka bërë një vlerësim dhe i duhet ky vlerësim. Në 2004 paskemi pas një vlerësim prej 1miliard tash sipas këtij këshilltari transaksionit është vlera diku maksimumi 600 milion euro nëse shitet qind për qind. Habit fakti pse ne vet nuk e kemi bërë një vlerësim por e ka bërë një këshilltar i jashtëm. Mendoj që na duhet ta kemi një vlerësim dhe nëse është vlerësimi ynë 600 apo 800 milion apo 1 miliard kur ta vejmë në shitje e të na japin 300 milion mendoj se nuk është e domosdoshme ta shesim menjëherë për 300 milion. Një aspekt tjetër që ndoshta edhe ja zvogëlon vlerën por edhe ja zvogëlon fitimet e mëdha që ka PTK-ja është edhe shitja e kartelave dhe e mbushjeve në rrugë, një numër që kushton 5 euro në PTK e që ska shitet në rrugë para PTK-së për 10euro. Sikur PTK-ja të kishte bërë një menaxhim më të mirë të gjithë situatës përfitimet do të ishin shumë më të mëdha për Qeverinë. Të çështja 75 me 25 % mendoj që ju e keni bërë këtë për arsye politike, mendoj se janë arsye psikologjike që të mos i duket dikujt që s'ka dëshirë ta shesë PTK-në që po shitet qind për qind por po ja lëmë 25% që në aspektin psikologjik ai të jetë më i qetë. Nuk është me logjikën e tregut, desha të them se ju nuk e keni bërë një vlerësim të vërtetë sa është interesi i shtetit të Kosovës. Shtetet që kanë qenë me sistem komunist kanë bërë shitjen e Postës në përqindje të ndryshme, por i kemi disa raste interesante për shembull Austria dhe Turqia që asnjëherë s'kanë qenë shtete moniste por kanë pas ekonomi tregu nuk e kanë bërë privatizimin e Postës në masë sikurse shtetet që janë në tranzicion. Nuk duhet të harrojmë se vetëm dy vitet e fundit PTK-ja i ka dhënë Kosovës 280 milion euro që është një shumë e madhe që do të thotë nëse do të kishim përfitime të këtilla edhe në të ardhmen është interes i Kosovës që të mos e privatizojë në këtë fazë. Ne kemi nevojë që të na sillni argumente pak më të fuqishme dhe më bindëse lidhur me çështjet që i shtruum me dilemat që i kemi në mënyrë që ne ta marrim një vendim shumë meritator i cili do të ishte në interes të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kryetarja – Duke marrë parasysh se të gjitha komentet edhe argumentet nga Ministri edhe kundër argumente nga deputetët të cilët japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në mënyrë shumë të drejtë, dhe shumë transparente për çështjen e privatizimit të PTK-së.

Atëherë prej gjithë Komisionit kërkoj që a janë të pajtimit që kjo strategji si është të shkojë në seancë pa kurrfarë Rekomandimi të Komisionit, dhe vendosë seanca me 120 deputet se çka do të ndodhë apo të lemë edhe një mundësi tjetër të diskutojmë, të vendosim bashkërisht si Komision se si do të procedojmë bashkërisht.

Zef Morina – propozoj që do të ishte mirë të kemi edhe një mbledhje ku do të shqyrtohej nga Komisioni dhe të nxjerrim rekomandime. Ne kemi nesër edhe një dëgjim publik për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Telekomunikacionin ku mund të dalin sugjerime të reja.

Adem Grabovci – tha që nuk kemi asgjë të re për të shtuar, as Ministri nuk ka diçka më tepër që do të na thotë neve në takimin e ardhshëm. Nuk jam kundër asaj që nëse shihet e arsyeshme të shtyjmë edhe për një mbledhje ne e shtyjmë mirëpo ne veç e zhagisim punën edhe përsëri do të jemi në këtë pikë këtu ku jemi.

Kryetarja – Duke marrë parasysh se nesër në ora 12:00 është Dëgjimi Publik për Ligjin e Telekomunikacionit ku do të jetë i pranishëm Drejtori i PTK-së, do të jetë Bordi i ART-së, do të jetë MTPT-ja, do të ketë ekspertë të kësaj fushe. Janë të ftuar njerëzit e vullnetit të mirë, ne jemi të obliguar si Komision që çdo dokument që vjen brenda Komisionit Parlamentar t’ia drejtojmë seancës plenare.

Ethem Çeku - Jemi që kjo strategji të shkojë sa më parë për miratim, por për hir që projekti të ketë sukses, ministria të ketë sukses mendoj që duhet të plotësohet posaçërisht ku është përballë infrastruktura dhe nuk do doja ky projekt ta merr fatin e Kosovës Re.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

i. Shtyhet shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës për mbledhjen e radhës;

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani